

DEKRET
Nr.6218, datë 7.7.2009

**PËR KRIJIMIN E SEKSIONEVE PENALE PËR GJYKIMIN E TË MITURVE PRANË
GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 13, paragrafi 4 të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, seksionet penale për gjykimin e të miturve krijohen në:

1. Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Dibër, Krujë, Kurbin, Mat dhe Tiranë.
2. Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Durrës dhe Kavajë.
3. Gjykatën e rrethit gjyqësor Shkodër, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Lezhë, Kukës, Pukë, Shkodër dhe Tropojë.
4. Gjykatën e rrethit gjyqësor Vlorë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Berat, Fier, Lushnjë dhe Vlorë.
5. Gjykatën e rrethit gjyqësor Korçë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Korçë dhe Pogradec.
6. Gjykatën e rrethit gjyqësor Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Gjirokastrë, Përmet dhe Sarandë.
7. Gjykatën e rrethit gjyqësor Elbasan, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Elbasan.

Neni 2

Dekreti nr. 5351, datë 11.6.2007 “Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi më 1 shtator 2009.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi